

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7044  
E premte, 10 nëntor 2023  
Çmimi 0.50 €

Raporti i Progresit  
për Kosovën njih  
përparim të caktuar FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

AMBASADORI AMERIKAN NË KOSOVË, JEFFREY HOVENIER, NË NJË KONFERENCË PËR MEDIE KA FOLUR PËR DRAFT-STATUTIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE FAQE 4-5

## HOVENIERI THOTË SE GJYKATA KUSHTETUESE DO TA THOTË FJALËN E FUNDIT PËR DRAFT-STATUTIN PËR ASOCIACIONIN

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të enjten se draft-statuti që i është propozuar Kosovës duhet të jetë në përputhje me vendimet e Gjykatës Kushtetuese, nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk duhet të ketë nivel shtesë të pushtetit. Ai në një konferencë për medie ka thënë se Gjykata Kushtetuese do ta thotë fjalën e fundit për draft-statutin për Asociacionin. Hovenieri ka theksuar se është habitur me numrin e njerëzve që e kanë interpretuar një draft-statut të cilin nuk e kanë parë



### AKTUALE



SHQIPËRI, SHUMICA MIRATON PROJEKTILIGJET NËN GAZIN LOTSJELLËS F. 3

KANIN: NJOHJA DE FACTO NUK I ZGJIDH PROBLEMET NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË F. 5

KUVENDI MIRATON DEKLARATËN NË MBËSHTETJE TË REZOLUTËS SË PE-SË PËR SULMIN NË BANJSKË F. 4

### EKONOMI



PLANI EKONOMIK I BE-së: KOSOVA DHE SERBIA KUSHTËZOHEN ME NORMALIZIM RAPORTESH F. 8

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR MBËSHTETJE PËR MARRJEN E VLERËSIMIT KREDITOR TË KOSOVËS F. 8

### SPORT



SPEKTAKËL SPORTIV NË MALISHEVË, RUDAJ MBRON TITULLIN NË 'MUAY THAI' F. 10

KUVENDI NUK MIRATON REZOLUTËN PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË POLICËVE, AS PËR RRRITJEN E KOEFICIENTIT TË PAGAVE FAQE 4



BASHKËPUNIMI NDËRMJET DY USHTRIVE KOSOVË - GJERMANI, GJENERAL JASHARI TAKON GJENERALIN BREUER FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

Endrit Shaqiri  
+38344685122

**INFINITY**  
Digital Agency  
Internet Website,  
Marketing...

## Italia nis anije spitalore në Lindje të Mesme për t'u ndihmuar palestinezëve

ROMË, 9 NËNTOR - Italia e ka nisur një anije spitalore në Lindje të Mesme për t'u ndihmuar palestinezëve, e cila pritet të arrijë atje "brenda disa ditësh", ka thënë Ministria italiane e Mbrojtjes të enjten.

Në anijen "Vulcano", e cila është e pajisur me dhoma operimi, janë edhe 30 pjesëtarë të stafit mjekësor. Ajo fillimisht do të nisët drejt Qipros, ka thënë ministria, por nuk ka treguar sa afër Gazës do të jetë. Ministri italian i Mbrojtjes, Guido Crosetto, ka thënë se pas

disa ditësh do t'i nisin përgatitjet edhe për një spital fushor ushtarak, duke e konkretizuar "ndihmën humanitare për Rripin e Gazës".

Ai ka thënë për mediet italiane se beson që "një iniciativë e tillë do të mirëpritet nga Izraeli, po aq sa prej palestinezëve". "Askush nuk do të mund të thotë asgjë për një akt humanitar".

Ministria ka thënë se është e gatshme të dërgojë më shumë staf mjekësor kur të

funksionalizohen spitalet, përfshirë dy anesteziologë, dy kirurgë dhe tetë infermierë. Rripi i Gazës është duke u bombarduar prej ushtrisë izraelite qysh prej sulmeve të Hamasit në tokën e tij më 7 tetor.

Militantët e Hamasit e kanë sulmuar jugun e Izraelit, duke i vrarë mbi 1 400 njerëz, kryesisht civilë, dhe duke i marrë mbi 240 pengje.

Duke u zotuar se do ta shkatërrojë Hamasin, Izraeli është hakmarrë me



bombardime të vazhdueshme dhe ofensivë tokësore, të cilat, sipas autoriteteve

palestinezëve, i kanë vrarë mbi 10 500 njerëz, shumica prej tyre fëmijë.

## Izraeli vazhdon bombardimet në qytetin e Gazës

GAZA, 9 NËNTOR - Sulmet ajrore izraelite e kanë goditur edhe të enjten qytetin e Gazës, teksa ushtarët janë përballur lagje për lagje me militantët e grupit palestinez Hamas.

Ndërkohë, mijëra palestinezë janë të dëshpëruar dhe në kërkim të sigurisë, derisa largohen prej shtëpive të tyre në pjesën veriore të Gazës së rrethuar.

Pas më shumë se një muaji të bombardimeve masive, qindra mijëra njerëz po përballen me "situatë të rëndë humanitare" në zonat e luftimeve në Gazë dhe kanë mbetur pa ujë dhe ushqime të mjaftueshme, kanë thënë Kombet e Bashkuara.

Ministri izraelit i Mbrojtjes, Yoav Gallant, ka thënë të mërkurën se forcat e tij janë duke "ashpërsuar rrethimin" në qytetin e Gazës.

Izraeli i ka shpallur luftë Hamasit, pas sulmit të grupit në tokën e tij më 7 tetor, duke i vrarë 1 400 njerëz, kryesisht civilë, dhe duke regjistruar sulmin më të keq në historinë e Izraelit.

Militantët i kanë marrë edhe mbi 240 pengje, duke përfshirë edhe foshnja dhe persona të moshuar. I zotuar se do ta shkatërrojë Hamasin, Izraeli është hakmarrë me bombardime të vazhdueshme dhe ofensivë tokësore, e cila, sipas autoriteteve palestineze, i ka vrarë mbi 10 500



njerëz, shumica prej tyre fëmijë. "Ne kemi humbur shtëpitë tona, ne i kemi humbur fëmijët tanë. Ku është komuniteti global?", ka pyetur Nouh Hammouda, një prej palestinezëve sa ka qenë duke ikur.

Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu e ka kundërshtuar vazhdimisht mundësinë e armëpushimit derisa të lirohen pengjet e marra prej Hamasit. Sipas disa burimeve të lidhura me Hamasin, janë duke u

zhvilluar bisedime për lirim të 12 pengjeve, përfshirë gjashtë amerikanë, në këmbim të tri ditëve armëpushim.

Zëdhënësi për Siguri Kombëtare i Shteteve të Bashkuara, John Kirby, ka thënë se Uashingtoni "e ka një mënyrë të komunikimit me Hamasin", mirëpo dhënia e më shumë hollësive mund ta dëmtojë procesin.

Ndonëse luftimet shtohen, në anën tjetër kanë nisur diskutimet se si do të jetë e ardhmja e Gazës

pasi të përfundojnë luftimet. Netanyahu ka thënë këtë javë se Izraeli do të jetë përgjegjës për "sigurinë e përgjithshme" të territorit.

Kirby ka thënë të mërkurën se diçka e tillë mund të ndodhë për një periudhë kohore. Izraeli e ka pushtuar Gazën në luftën gjashtëditore të vitit 1967 dhe është tërhequr nga ky territor më 2005. Dy vjet më vonë, Hamasi e ka marrë kontrollin e rajonit dhe Izraeli i ka vënë bllokadë të

ashpër.

Në periudhë afatgjatë, sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka sugjeruar se Autoriteti Palestinez, i cili ushtron autonomi të kufizuar vetëm në disa pjesë të Bregut të pushtuar Perëndimor, duhet ta rimarrë kontrollin në Gazë. "Duhet të ketë udhëheqësi palestinez dhe Gaza të jetë e unifikuar me Bregun Perëndimor nën Autoritetin Palestinez", ka thënë Blinkeni të mërkurën, duke e përsëritur qëndrimin e ShBA-së për zgjidhje me dy shtete.

Mirëpo zrytari i lartë i Hamasit, Ezzat al-Reshq, ka marrë tjetër qëndrim. "Të gjitha fuqitë e botës bashkë nuk do të mund t'i aplikojnë kushtet dhe kukullat e tyre" te palestinezët, ka thënë ai përmes një mesazhi në "Telegram".

Shefi i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Volker Turk, e ka dënuar Izraelin për bombardimet dhe urdhrat për palestinezët që të ikin prej veriut të Gazës. "Ndëshkimet kolektive të Izraelit ndaj civilëve palestinezë përbëjnë, po ashtu, krim lufte, ashtu sikurse evakuimi i detyrueshëm i civilëve", u ka thënë ai gazetarëve në pikën kufitare Rafah me Egjiptin, rrugën e vetme për largim prej Gazës, që nuk kontrollohet prej Izraelit.

## BE-ja bën rregulla të repta, ligj të ri për kufizimin e reklamave të partive politike në rrjetet sociale

BRUKSEL, 9 NËNTOR - Së shpejti BE-ja pritet të ketë rregulla më të repta për reklamën politike në rrjetet sociale. Edhe ndikimi nga shtete të treta, në zgjedhjet e vendeve anëtare të BE-së do të ndalohet. Mikrotargetingu është prej kohësh pjesë e medieve sociale. Fjala është për reklamën që është praktikë politike bënë me adresim të targetgrupe të caktuara të

zgjedhësve. Gjatë këtij procesi grumbullohen të dhëna të personave nga mediet sociale për t'i kontaktuar direkt këto targetgrupe. Këtë strategji të komunikimit politik, Barack Obama e ka përdorur që në vitin 2008. Por ajo u përfol shumë dhe u bënë publike praktikat që përdorte agjencia e rrjeteve sociale, Cambridge Analytica. Kjo agjenci që ka

punuar, ndër të tjera, për ekipin e zgjedhjeve të Donald Trumpit, ka zotëruar në mënyrë joligjore të dhëna të miliona përdoruesve në "Facebook".

Mikrotargetingu nuk do të jetë lejohet në të ardhmen pas ligjit të ri. Këtë javë si Këshilli i BE-së edhe Parlamenti Evropian ranë dakord për ligjin e ri, i cili tashmë pritet të votohet vetëm formalisht.



# Kuvendi nuk miraton rezolutat për mbështetje financiare të policëve dhe rritjen e koeficientit të pagave

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Kuvendi i Kosovës nuk i ka miratuar të enjten propozim-rezolutat për mbështetjen urgjente financiare për pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe atë për nevojën e rritjes së koeficientit të paga. Rezolutat janë shprehje e vullnetit politik të Kuvendit për çështje të caktuara, por të cilat nuk kanë karakter obligues. Për miratim të saj kanë votuar 25 deputetë, ndërsa 59 kanë abstenuar.

Propozim-rezoluta është paraqitur në Kuvend javë më parë prej partive opozitare. Ndërkohë, Qeveria e Kosovës i ka paraqitur shtesat e rrezikshmërisë për pjesëtarët e Policisë së Kosovës. Qeveria e ka ndarë shumën e shtesave në shtatë kategori, varësisht prej pozitave të zyrtarëve në Policinë e Kosovës. Si përgjigje, Njësia Speciale Intervenuese dhe Njësia për



Trajtimin e Mjeteve Eksplozive kanë protestuar para objektit të Qeverisë së Kosovës duke kërkuar nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, rishikimin e vendimit për shtesat. Ata kanë kërkuar kategorizim si njësi të veçanta, përfshirje në

listën e ekspertëve, që rrezikshmëria të caktohet në 50 për qind të pagës bazë, si dhe shtesa për kushte specifike të punës. Pagat e policëve të Kosovës nisin nga 210 euro në muaj për kadetët policorë dhe arrijnë në

mbi 1 500 euro në muaj për drejtorin e përgjithshëm. E formuar 24 vjet më parë, Policia e Kosovës ka mbi 9 000 pjesëtarë me grada të ndryshme. Ata nuk kanë as sigurim shëndetësor, as jetësor.

## Projektrezoluta për koeficient të pagave

Projektrezolutën për ngritje të koeficientit të pagave në 129 euro e pati prezantuar partia opozitare Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Për miratim të rezolutës kanë votuar 28 deputetë, 52 kanë qenë kundër dhe katër kanë abstenuar.

Buxheti i shtetit të Kosovës për këtë vit është 3.2 miliardë euro, ndërsa projektbuxheti për vitin 2024 parasheh fond prej 3.3 milionë eurosh. Koeficienti për këtë vit është 105 euro, ndërsa në projektbuxhet është përmendur rritje prej 5 eurosh për vitin e ardhshëm.

# Shqipëri, shumica miraton projektligjet nën gazin lotsjellës

TIRANË, 9 NËNTOR - Kuvendi i Shqipërisë nuk arriti as këtë të enjte të zhvillojë seancë të qetë. Deputetët e opozitës, mbështetës të ish-kryeministrit Sali Berisha, bllokuan foltoren e Kuvendit duke vendosur aty karrige dhe më pas hodhën gaz lotsjellës.

Pas kësaj situatë, kryetarja e Kuvendit, Lindita Nikolla, përjashtoi deputetin e opozitës, Saimir Korreshi, i cili hodhi gazin lotsjellës në sallë. Mes kaosit të krijuar, shumica votoi projektligjet e përcaktuara në rendin e ditës.

Gjashtë prej tyre, që ishin propozime të Partisë Demokratike në opozitë, u rrëzuan. "Do të ishte e udhës që deputetët e opozitës ta merrnin fjalën dhe t'i shpjegonin qëllimet pse kanë marrë këto iniciativa ligjore. Mos u keqpërdorni nga interesi personal i një njeriu, që ka marrë peng PD-në prej 33 vitesh. Vendosja e flakadanëve dhe lëndëve kimike, është një veper penale", tha Balla.



Seanca u mbyll pas 20 minutash, mes tymit të shkaktuar nga gazi lotsjellës dhe bllokimit të foltores me karrige.

Ish-kryeministri Sali Berisha tha se situata e krijuar është përgjegjësi e pushtetit që, sipas tij, "po asgjëson pluralizmin".

"Kanë tmerr nga të drejtat kushtetuese të opozitës. Parlamenti po funksionon njëllë si në diktaturë. Nevojitet

rivendosja e të drejtave kushtetuese të deputetëve, dhe lejimi i krijimit të komisioneve hetimore parlamentare që janë frenuar nga Edi Rama", theksoi ai. Berisha deklaroi se bllokimi i komisioneve dhe seancave parlamentare do të vijojë derisa të plotësohen kërkesat e opozitës.

Deputetët e opozitës akuzojnë shumicën për refuzimin e ngritjes së disa komisioneve hetimore, dhe se po kërkon t'i imponojë përfaqësuesit e opozitës në komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore, kjo për shkak të përplasjeve brenda Partisë Demokratike.

Kreu i grupit të Partisë Socialiste, Bledi Çuçi, u shpreh pas mbylljes së seancës se shumica "do të vazhdojë të miratojë ligje dhe të qeverisë".

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, dhe deputetët që e mbështesin atë, nuk morën pjesë në seancë, ashtu siç kanë bërë edhe në dy seancat e kaluara, kur është krijuar e njëjta situatë.

## Gërvalla: Institucionet e Kosovës, të përkushtuara për përmbushjen e kërkesave të qytetarëve të Luginës

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Zëvendëskryeministria dhe ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka pritur në takim përfaqësuesit e OJQ-së "Drejtoria për Inkluzion" nga Lugina e Preshevës. Ministria Gërvalla në takimin me përfaqësuesit e kësaj organizate ka diskutuar për

rolin dhe rëndësinë e organizatave joqeveritare në Luginën e Preshevës, gjendjen e shqiptarëve në Luginë dhe mundësitë e mbështetjes së tyre përmes projekteve konkrete.

Ministria Gërvalla, pas diskutimit me përfaqësuesit e OJQ "Drejtoria për Inkluzion", shprehu mbështetjen e plotë

dhe gatishmërinë që të adresohen kërkesat e tyre. Ajo theksoi se institucionet e Republikës së Kosovës janë të përkushtuara për trajtimin dhe përmbushjen e kërkesave të qytetarëve të Luginës së Preshevës dhe projektet të cilat janë në interes dhe në shërbim të përmirësimit të jetesës së qytetarëve.





AMBASADORI AMERIKAN NË KOSOVË, JEFFREY HOVENIER, NË NJË KONFERENCË PËR MEDIE KA FOLUR PËR DRAFT-STATUTIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE

# Hovenier thotë se Gjykata Kushtetuese do ta thotë fjalën e fundit për draft-statutin për Asociacionin

Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të enjten se draft-statuti që i është propozuar Kosovës duhet të jetë në përputhje me vendimet e Gjykatës Kushtetuese, nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive dhe nuk duhet të ketë nivel shtesë të pushtetit. Ai në një konferencë për medie ka thënë se Gjykata Kushtetuese do ta thotë fjalën e fundit për draft-statutin për Asociacionin. Hovenieri ka theksuar se është habitur me numrin e njerëzve që e kanë interpretuar një draft-statut të cilin nuk e kanë parë

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 9 NËNTOR** - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të enjten se draft-statuti që i është propozuar Kosovës për formim të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe i përmbush të gjitha kriteret që i parashohin Shtetet e Bashkuara për të. "Duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën aktuale të Kosovës. Nuk duhet të kërkohen ndryshime kushtetuese. Duhet të jetë në përputhje me vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive. Nuk duhet të ketë nivel shtesë të pushtetit. Ne besojmë se ky draft, që i është

dorëzuar Qeverisë së Kosovës, i përmbush të gjitha këto kriteret, dhe besojmë se është shkruar në një mënyrë që është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës", ka thënë ai. Hovenieri ka thënë para medieve se, megjithatë, fjalën e fundit për këtë draft duhet ta japë Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe një prej dispozitave të draftit është se ai do të analizohet nga kjo gjykatë. Për Hovenierin "e gjithë histeria lidhur me kushtetutshmërinë nuk na duket me vend, sepse është bërë punë me kujdes në hartim të draftit". I pyetur pse drafti nuk është bërë publik, ai ka thënë se nuk ka asgjë sekrete, mirëpo këto janë vetëm çështje diplomatike në të mirë të

procesit. "Jam habitur me numrin e njerëzve që e kanë interpretuar një draft-statut që nuk e kanë parë. Është trik goxha mbresëlënës. Në fund të ditës, ata që nuk e kanë parë dokumentin, nuk kanë shumë bazë të komentojnë mbi të". Propozimi i zyrtarëve perëndimorë për formim të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë u është prezantuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit dhe presidentit serb, Aleksandar Vuçiq, më 21 tetor nga përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara (ShBA), Bashkimit Evropian (BE), Francës, Gjermanisë dhe Italisë. Hovenieri është pyetur edhe nëse ekzistojnë afate kohore për

zbatim të këtij draft-statuti. Ai ka thënë se duhet vlerësuar angazhimin e madh të zyrtarëve më të lartë të vendeve evropiane për këtë proces, përfshirë kancelarin gjerman Olaf Scholz, presidentin francez Emmanuel Macron dhe kryeministren italiane Giorgia Meloni. "Ata i përdorin shprehjet 'urgjente', 'sa më shpejt që është e mundur', e të ngjashme. Ekziston një urgjencë, ka kërkesë që gjërat të lëvizin shpejt. Qeveria e Kosovës nuk ka arsye për të mos ecur përpara me këtë draft-statut. Kryeministri ka thënë se ka gatishmëri ta pranojë në tërësi javë më parë. Edhe ne po punojmë që kjo gjë të bëhet në kuadër të strategjisë sonë më të gjërë. Nuk ka të bëjë vetëm me Asociacionin. Ka të bëjë me zbatimin e plotë të të gjitha obligimeve që i kanë Kosova dhe Serbia në Marrëveshjen Bazë dhe aneksin e Ohrit. Këtë dëshirojmë ta shohim", ka thënë Hovenier. Ai i është referuar pajtueshmërisë së arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë në shkurt të këtij viti në Bruksel për normalizim të marrëdhënieve mes dy vendeve. Më pas, në mars, në Ohër, palët

janë pajtuar për një aneks zbatim. Në një pikë të marrëveshjes përmendet edhe nevoja për formim të një niveli të vetëmenaxhimit të serbëve në Kosovë, referencë për Asociacionin. Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës gjeti se marrëveshja nuk ishte në përputhje të plotë me Kushtetutën, prandaj Prishtina zyrtare nuk pranoi ta zbatonte atë marrëveshje. Nga ana tjetër, Beogradi ka ngulur këmbë që Asociacioni të formohet ashtu siç është arritur pajtim në Bruksel, e jo që disa pika të harmonizohen me Kushtetutën e Kosovës, siç ka propozuar Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Kurti ka raportuar më 3 nëntor para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke thënë se ende nuk e ka pranuar zyrtarisht dokumentin, por ka insistuar se është shkruar me kujdes ndaj germës së Kushtetutës, më shumë sesa frymës së saj. "Ta

# Kanin: Njohja de facto nuk i zgjidh problemet në mes të Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 9 NËNTOR - David Kanin, profesor për Studime Evropiane në Universitetin "Johns Hopkins" në ShBA, nuk shpreh optimizëm se kërkesat e ndërkombëtarëve që Serbia ta njohë de facto Kosovën dhe Kosova ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe do t'i zgjidhin problemet mes dy vendeve.

Për të pasur një zgjidhje të qëndrueshme, sipas tij, ajo duhet të vijë nga vetë protagonistët e jo të imponohet prej jashtë. "Një të tillë e kemi pasur në vitin 2018, me planin e ndarjes [shkëmbimit të territoreve]. Askujt nuk i ka pëlqyer, të gjithë i kanë nxjerrë në dukje problemet dhe ato kanë qenë reale. Por, fakti që ka ardhur nga të dyja palët, që [presidenti i Serbisë, Aleksandar] Vuçiq dhe [presidenti i atëhershëm i Kosovës, Hashim] Thaçi, kanë qenë të gatshëm për të bashkëpunuar, është dashur të ishte pika më e rëndësishme", thotë Tanin për "Radion Evropa e Lirë".

Në pyetjen se cili do të duhej të ishte modeli për Asociacionin që nuk do ta rrezikonte funksionalitetin e shtetit të Kosovës, ai ka thënë se me formimin e Asociacionit serbët në

Kosovë do të kishin një organizatë që do të njihej botërisht, ndërkohë që vetë Kosova nuk njihet. "Ky është problemi. Ky model e rrezikon. Unë e kuptoj se do të kishte përgjegjësi të zakonshme, në shëndetësi, në arsim... Edhe aktivistët e shoqërisë civile që e mbështetnin, thonë se do të ketë me të vërtetë përgjegjësi shumë të kufizuara. Por, kjo nuk ka rëndësi. Ajo që ka rëndësi është se serbët në Kosovë do të kenë një organizatë që do të njihet botërisht, ndërsa vetë Kosova nuk njihet. Dhe do të jetë një lloj mjeti, pa marrë parasysh se cilat do të jenë funksionet e tij zyrtare. Të dyja qeveritë [në Kosovë dhe Serbi] e dinë se ai do të jetë një mjet për Listën Serbe për ta zgjeruar shtrirjen e saj në Kosovë dhe, në veçanti, në jug të Lumit Ibër. [v.j. Lista Serbe është partia më e madhe e serbëve në Kosovë, e cila mbështetet nga Beogradi zyrtar]."

Për sulmin në Banjskë thotë se ka shumë pyetje që "mbeten në ajër, por, "me shumë gjasa, duket se dikush në zinxhirin komandues ushtarak ose të inteligjencës në Beograd, ka pasur lidhje me të". "Unë mendoj se ideja e vendosjes së sanksioneve ndaj Vuçiqit është



tani shumë poshtë në listën e prioriteteve, marrë parasysh gjithçka që po ndodh në Lindjen e Mesme", thotë Tanin në pyetjen se a po u shmanget Serbia sanksioneve të mundshme nga Perëndimi.

I pyetur nëse Vuçiqi do ta ndryshojë qasjen ndaj dialogut me Kosovën pas zgjedhjeve të dhjetorit në Serbi, Kanin ka thënë se pritet të

shihet se çfarë do të ndodhë në ato zgjedhje. "Të shohim se çfarë do të ndodhë në zgjedhje. Gjëja e rëndësishme në këto zgjedhje, sipas meje, nuk ka të bëjë me Kosovën. Ka të bëjë me vrasjet masive që kanë ndodhur në Serbi majin e kaluar. Mendoj se ato kanë qenë kërcënimi më i madh për Vuçiqin prej se ka marrë pushtetin. Nëse opozita pro-perëndimore

mund të përfitojë nga zemërimi i njerëzve me Vuçiqin - që është ndër pas vrasjeve - atëherë ajo mund të ketë shanse që të dalë më mirë në zgjedhje. Nëse Vuçiqi ia del ta ruajë kontrollin, ai nuk do të ndryshojë asgjë në lidhje me Kosovën", ka thënë David Kanin, profesor për Studime Evropiane në Universitetin "Johns Hopkins" në ShBA.

## Kuvendi miraton Deklaratën në mbështetje të Rezolutës së PE-së për sulmin në Banjskë



PRISHTINË, 9 NËNTOR - Kuvendi i Kosovës ka miratuar të enjten Deklaratën në mbështetje të Rezolutës së Parlamentit Evropian mbi zhvillimet e fundit në dialogun Kosovë - Serbi, përfshirë situatën në komunat veriore të Kosovës. Nga 88 deputetë të pranishëm, 86 votuan për miratimin e kësaj deklaratë.

Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, paraqiti para deputetëve pikat e kësaj deklaratë: 1. Kuvendi

vlerëson lart të gjitha qëndrimet politike të PE-së në lidhje me cenimin e integritetit territorial nga Serbia; 2. Mbështet fuqishëm thirrjet për ta mbajtur përgjegjëse ndërkombëtarisht Serbinë si subjekt i hetimit ndërkombëtar; 3. I bashkëngjitet kërkesës së PE-së që sa më parë të ekstradohen në Kosovë planifikuesit e sulmit dhe cildo subjekt që e ka asistuar këtë sulm; 4. Vlerëson lart qëndrimet përmes të cilave nënvizohet rëndësia e heqjes së masave ndaj Kosovës dhe vendosjen e masave

ndëshkuese ndaj Serbisë; 5. Fton Parlamentin që të luajë rol ende më fuqishëm në lidhje me qëndrimin që mbajnë 5 vendet mosnjohëse që ta njohin pavarësinë e Kosovës; 6. Vlerëson lart kritikën që PE i jep qasjes destruktive të Serbisë; 7. Fton PE-në ta marrë në shqyrtim dhe të vlerësojë aplikimin e Kosovës për statusin e vendit kandidat. Para miratimit të kësaj deklaratë shefat e grupeve parlamentare u konsultuan për ta harmonizuar përbajtjen e saj.

pranosh nënkupton të pajtohesh që të ndërmarrësh obligime për zbatimin e draftit", ka thënë ai, duke shtuar se ai ka ofruar që ta nënshkruajë atë dhe, "si rrjedhojë, ta pranojë". Sipas tij, draft-statuti sqaron situatën në lidhje me njohjen e Kosovës dhe "e ndërpret trashëgiminë mosnjohëse të Republikës së Kosovës që ishte çimentuar në marrëveshjet e vitit 2013 dhe 2015". Sipas tij, parashihet që ky dokument të shkojë për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Emisari evropian Miroslav Lajçak këtë javë ka qëndruar për vizitë dyditore në Kosovë, ku ka zhvilluar takime me përfaqësuesit e partive opozitare dhe me ambasadorët e akredituar në Kosovë, me të cilët ka biseduar për draft-

statutin e ri të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Përfaqësuesi i PDK-së dhe ai i LDK-së kërkuar të dinë më shumë hollësi rreth draft-statutit dhe u ankuan se po mbahen "në terr" për shkak të mosparaqitjes së dokumentit, ndërsa lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, pretendoi se në takim opozitarëve u është paraqitur draft-statuti dhe e kanë lexuar në tërësi.

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, pas takimit me liderët opozitarë në Prishtinë, tha se kishte një ditë "shumë produktive në Kosovë me shkëmbime të mira për zhvillimet më të fundit në dialogun e lehtësuar nga BE-ja dhe për rrugën përpara".



## Haxhiu ftohet për të dëshmuar në Prokurorinë Speciale lidhur me deklaratën e saj për rastin Dehari

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka njoftuar të enjten se është ftuar nga Prokuroria Speciale të dëshmojë lidhur me rastin e Astrit Deharit. "Prokurori Special, Afrim Shefiku, paska kërkuar nga unë që të

përgjigjem se kush janë vrasësit e Astrit Deharit! E gjithë kjo bazuar në një status timin në rrjetet sociale, në përvjetorin e Astrit Deharit. Është një gjë e thjeshtë që duhet ta di një prokuror. Ministri i Drejtësisë nuk mund të jetë prokuror e as

gjuqtar. Unë nuk mund t'i marrë përgjegjësitë e tij. Lëndën e Astrit Deharit, prokurori Afrim Shefiku e ka që nga viti 2019 dhe ende nuk ka asnjë rezultat në zbardhjen e këtij rasti. Ai është përgjegjës për t'i treguar familjes dhe qytetarëve se

kush janë vrasësit!", ka thënë Haxhiu përmes një njoftimi në "Facebook", duke shtuar se do të japë dëshminë e saj lidhur me këtë. "Prokurori Shefiku dhe eprori i tij nuk mund të na heshtin në kërkesën tonë për drejtësi", ka shkruar Haxhiu.



## Kryevepra e Picassos shitet 139 milionë dollarë

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Kryevepra e Pablo Picassos e vitit 1932, Femme a la Montre (Gruaja me orë), është shitur për 139 milionë dollarë, sipas qendrës për ankande Sotheby. Kjo është vepra e dytë më e shtrenjtë që është shitur nga ky artist spanjoll. Por, Femme a la Montre (Gruaja me orë) është bërë vepra e shitur më së shtrenjti në ankand këtë vit. Në të artisti e ka portretizuar Marie-Therese Walter, modelen franceze me të cilin ka pasur lidhje dashurie, dhe e ka pasur frymëzim edhe për piktura të tjera. Fillimisht piktura është vlerësuar 120 milionë dollarë para se të vendosej në shitje. Kjo pikturë e artistit spanjoll ka qenë më parë në pronësi të koleksionistes së artit Emily Fisher Landau, e cila e ka blerë atë më 1968. Vepra tani është blerë prej një blerësi anonim. Femme a la Montre është portret i Walterit, e ulur në një

karrige që ngjan me fron mbretëror dhe e ka një prapavijë të kaltër. E njohur si "muza e artë" e Picassos, Walter ka qenë 17-vjeçare kur është takuar me Picason 45-vjeçar në Paris, dhe e kanë nisur një lidhje sekrete, pasi ai ka qenë ende i martuar me Olga Khokhlova, balerinë ukrainase. Piktura që është shitur më së shtrenjti në autorësi të Picassos është "Gratë e Algjerit", 179.3 milionë dollarë, më 2015. I lindur në Mallaga më 1881 dhe i rritur në Barcelonë, Picasso është zhvendosur në Paris më 1904, dhe është bërë një prej artistëve më të rëndësishëm të shekullit 20. Ai i ka pasur katër fëmijë dhe ka vdekur në jug të Francës më 1973, në moshën 92-vjeçare. Ndonëse trashëgimia e tij kreative nuk është vënë kurrë në dyshim, në vitet e fundit rriten dilemat për sjelljen e tij. Ai është akuzuar për qasje mizore dhe shtrënguese.



## Bashkëpunimi ndërmjet dy ushtrive Kosovë - Gjermani, gjeneral Jashari takon gjeneralin Breuer



PRISHTINË, 9 NËNTOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Bashkim Jashari, së bashku me delegacionin përcjellës nga FSK-ja, janë pritur në takim pune në Ministrinë e Mbrojtjes në Berlin nga shefi i Mbrojtjes në Republikën Federale të Gjermanisë, gjeneral Carsten Breuer. Dy homologët diskutuan rreth situatës së përgjithshme të sigurisë në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Gjithashtu, theksuan rëndësinë e rritjes së

bashkëpunimit ushtarak ndërmjet ushtrive të dy vendeve. Gjeneralletenant Jashari e falënderoi homologun gjerman për mbështetjen e vazhdueshme që shteti gjerman, në veçanti Bundeswehri ka dhënë dhe po jep për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve të FSK-së. KOMFSK, gjithashtu, i ofroi homologut të tij bashkëpunim mes dy ushtrive përfshirë bashkëzbatimet në misionet të ndryshme, në operacione ndërkombëtare si dhe në fusha të

tjera të interesit të përbashkët. Gjenerali Breuer shprehu vlerësim të lartë për gjeneral Jasharin në funksion të ngritjes dhe profesionalizimit të kapaciteteve të FSK-së, si dhe për angazhimin që po e bëjnë në funksion të paqes në Ballkan, si dhe rritjes së bashkëpunimit mes dy ushtrive. Të dy shefat e mbrojtjes u pajtuan për thellimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve dhe me këtë rast gjeneral Jashari e ftoi gjeneralin Breuer për vizitë zyrtare në Kosovë.

## Në Prekaz dyshohet se u gjetën mbetje mortore të të zhdukurve të luftës

SKENDERAJ, 9 NËNTOR - Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur në Kosovë ka thënë të enjten se ekipet e tij kanë hasur në mbetje mortore të viktimave gjatë gërmimeve në Prekaz të Skenderajt. Sipas Komisionit, eshtrat e gjetur mund të jenë potencialisht të personave të zhdukur në luftën e fundit në Kosovë. Komisioni ka thënë se

gërmimet janë duke vazhduar ende, dhe se mbetjeve të gjetura do t'u bëhen analizat e ADN-së për identifikim të mundshëm. Përveç Prekazit, Komisioni ka thënë se ka kryer gërmime edhe në Arbanë të Prizrenit. Në luftën e zhvilluar në Kosovë më 1998/99 janë vrarë mbi 13 000 civilë. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të

pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë. Më 2 maj Kosova dhe Serbia, nën ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, kanë arritur marrëveshje për një Deklaratë për Personat e Zhdukur. Bekim Blakaj nga Fondi për të Drejtën Humanitare ka thënë se një vendim i tillë jep shpresë për qasjen në dokumentet e shënjuara si "konfidenciale".



# Raporti i Progresit për Kosovën njuh përparim të caktuar

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca dhe zëvendës-kryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, kanë pranuar Raportin e Progresit për Kosovën nga ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog.

Pas dorëzimit të raportit të Konjufca, ambasadori Szunyog ka theksuar se dokumenti paraqet një pasqyrë të zhvillimeve gjatë periudhës raportuese dhe identifikon sfidat për të ardhmen.

Pasi falënderoi ambasadorin Szunyog për punën në përpilimin e raportit dhe angazhimin e BE-së në Kosovë, kryetari Glauk Konjufca shprehu angazhimin për të punuar në drejtim të integritimeve evropiane si rrugë e qartë për Kosovën.

Konjufca ka thënë se raporti do të jetë një dokument orientues për punën e Kuvendit, përdorësi ka theksuar përkushtimin institucional për arritjen e objektivave të përcaktuara.

Pasi pranoi Raportin e Progresit për Kosovën, Bislimi dhe Szunyog kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për medie.

Zëvendëskryeministri Bislimi ka thënë se ky është raporti i parë pas aplikimit tonë për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit të kaluar, në të njëjtën kohë raporti e adreson për herë të parë vendimin final të BE-së se qytetarët e Republikës së Kosovës mund të udhëtojnë pa viza në zonën Shengen nga 1 janari i vitit 2024. "Raporti i vendit, mes të tjerash, konstaton se qeveria ka vazhduar agjendën e saj



ambicioze të reformave drejt BE-së. Gjatë kësaj periudhe raporti dëshmon arritje të rëndësishme legislative të kriteret politike si dhe zbatim të masave të progres në ato ekonomike si dhe standardet e BE-së. Në agjendën e integritimit evropian, Qeveria e Kosovës është vlerësuar për arritjet në zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA II) dhe Programin Kombëtar për Integrim Evropian 2023-'27", ka thënë ai.

Duke theksuar të arriturat në reformat e brendshme në sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë, progresin ekonomik dhe

social, liberalizimin e vizave dhe përkushtimin në bashkëpunimin rajonal, zëvendëskryeministri Bislimi ka thënë se procesi i anëtarësimit në BE duhet të jetë plotësisht i bazuar në meritokraci, por nuk mund të flasim për meritokraci përdorësi Kosova nuk është formalisht duke u vlerësuar se a i plotëson kriteret e Kopenhagës. "Kosova beson në të ardhmen e vet evropiane dhe si shembull i demokracisë në rajon, duhet t'i jepet mundësia që këtë edhe ta dëshmojë. Ne kemi bërë hapin tonë, kemi shprehur interesimin dhe kemi dorëzuar aplikacionin për anëtarësim në

BE. E shfrytëzoj edhe këtë rast, që ta ftoj BE-në, respektivisht Këshillin e BE-së, që ta mandatojë Komisionin Evropian që përmes pyetësorit ta bëjë vlerësimin tonë për statusin e kandidatit", ka thënë Bislimi, duke shtuar se Kosova vazhdimisht ka dëshmuar se është aleate e BE-së, sepse ajo beson në të ardhmen e vet evropiane.

Ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka thënë se ky raport njuh se ka përparim të caktuar, duke përfshirë themelimin e kornizës ligjore për zgjedhjet e parakohshme dhe disa çështje që lidhen me

shtensionimin në objektet komunale.

"Raporti thekson se duhet të shohim hapa të tjerë. Shpresojmë që hapat të merren sa më shpejt dhe masat të hiqen sa më shpejt që Kosova ta gëzojë potencialin jo vetëm nga mekanizmat ekzistues, por edhe nga plani i rritjes", ka thënë ai, duke iu referuar planit për rritje ekonomike të shteteve të Ballkanit Perëndimor, të miratuar më 8 nëntor. Ky plan është në vlerë prej 6 miliardë eurosh. Szunyog përsëriti qëndrimin e BE-së se e ardhmja e Kosovës është e bllokun evropian, duke theksuar se këto nuk janë deklarata boshe.

## Haradinaj për Raportin e Komisionit Evropian: Shqetësues, Kosova ka ecur prapa në marrëdhëniet me BE-në



PRISHTINË, 9 NËNTOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka komentuar Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, duke i quajtur të gjeturat shumë shqetësuese. Sipas tij, performanca e qeverisjes është e vlerësuar dobët si dhe është përmendur edhe çështja e korrupsionit. Ai sa i përket çështjes që Kosova nuk ka marrë rekomandimin për nisjen e negociatave, tha se kjo

ka ndodhur për shkak të qasjes së qeverisë së udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, në marrëdhëniet me BE-në dhe për shkak të sanksioneve. "Është priturore që vlerësimi do të jetë me mjaft çështje që janë shqetësuese për vendin, dhe janë adresuar shumica e këtyre shqetësimeve. Pra performanca e qeverisjes është vlerësuar dobët, po ashtu ka shumë fenomene të cilat janë identifikuar veç e veç. Ju e cekët çështjen e

korrupsionit, por ka edhe shumë çështje të tjera", ka thënë ai, duke shtuar se Kosova është ndëshkuar nga BE-ja. "Kemi sanksione edhe financiare, ekonomike, politike. Kuptohet pra se Kosova nuk është se ka ecur përpara, por ka ecur prapa në marrëdhëniet me BE-në. Edhe ato reflektojnë në këtë raport. Fatkeqësisht, edhe pasojat e atyre marrëdhënieve i kemi në jetën e përditshme", ka deklaruar Haradinaj.

## Osmani do të marrë pjesë në varrimin e ish-presidentit të Finlandës, Martti Ahtisaari

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Finlandë. Me ftesë të

qeverisë finlandeze, presidentja Osmani, krahas krerëve shtetërorë nga vende të tjera të botës, do të marrë pjesë në

varrimin e ish-presidentit të Finlandës dhe kryenegociatorit për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari. Në delegacionin

shtetëror të presidentes do të jetë edhe ish-presidenti Fatmir Sejdiu. Funerali i presidentit Ahtisaarit do të mbahet më 10 nëntor.



# Plani ekonomik i BE-së: Kosova e Serbia kushtëzohen me normalizim raportesh

PRISHTINË, 9 NËNTOR - As Kosova as Serbia nuk do të mund të përfitojnë nga plani i Komisionit Evropian për rritjen ekonomike në vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor në rast se nuk do të ketë përparim në procesin e normalizimit të raporteve ndërmjet tyre. Ky është kriteri shtesë që Komisioni Evropian ua ka vendosur dya vendeve. "Kjo shkon përmes pëmbushjes së obligimeve nga dialogu, si dhe respektimit të obligimeve në nismat rajonale", ka thënë një zyrtar i BE-së.

Komisioni Evropian ka miratuar më 8 nëntor një paketë të madhe të asistencës financiare prej 6 miliardë eurosh për periudhën nga viti 2024 deri në vitin 2027. Sipas planit, nga kjo shumë deri në 2 miliardë euro do të shkonin si asistencë pa kthim, ndërsa 4 miliardë në formën e kredive të favorshme apo investimeve kapitale. Një pjesë e këtyre mjeteve financiare do të mund të shkonin përmes pagesave direkte në buxhetet e vendeve të rajonit për t'u përdorur për këto qëllime. Kushtet për Kosovën dhe Serbinë janë përmendur edhe në dokumentet e Komisionit Evropian. "Një parakusht tjetër do të jetë që Serbia dhe Kosova të angazhohen në mënyrë konstruktive për t'i normalizuar raportet mes tyre me qëllim të zbatimit të plotë të të gjitha obligimeve që dalin nga Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit dhe aneksit, si dhe të gjitha marrëveshjet nga e kaluara nga dialogu dhe të angazhohen në negociatë për një

marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e raporteve", thuhet në këtë dokument.

Për Kosovën dhe Serbinë, nëse do të ketë përparim konkret në normalizimin e raporteve ndërmjet tyre, planifikohet të organizohet edhe një konferencë e veçantë donatorësh për ta ndihmuar financimin e projekteve me qëllim të përbashkët.

Kosova, aktualisht, është nën masat e BE-së për shkak se është vlerësuar se nuk ka ndërmarrë hapat e duhur për ta shtensionuar situatën në veri. Këto masa përfshijnë edhe mosshqyrtimin e disa projekteve nga Kosova që financohen përmes fondeve të para anëtarësimit të BE-së (IPA). BE-ja përsërit se "këto masa janë të përkohshme dhe mund të hiqen", por për një gjë të tillë nga Kosova kërkohet "të bëjë më shumë hapa për shtensionimin e situatës". Hapat që deri tash ka bërë Kosova konsiderohen "hapa në drejtim të duhur", por jo edhe të mjaftueshëm për t'u hequr masat.

Zyrtarët e BE-së kanë thënë se "është e logjikshme që të insistojmë në bashkëpunim maksimal mes vendeve të rajonit nëse qëllimi është që përmes tregut të përbashkët rajonal ato t'i sjellim në tregun unik të BE-së". Ata kanë tërhequr vërejtjen se kjo ndihmë do të ketë disa kushtëzime, që kryesisht lidhen me përshtatjen e kornizës ligjore të BE-së dhe sundimin e ligjit. Përveç ofertës së asistencës financiare, përfitimi nga ky plan do të jetë edhe në formën e hapjes



së mundësisë që vendet e rajonit të kenë qasje në tregun unik të BE-së, edhe para se të mund të bëhen anëtare të bllokut. Për këtë duhet t'i përshtatin disa ligje, kurse në disa fusha duhet të bëhen edhe ndryshime në Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit që vendet e rajonit i kanë me Bashkimin Evropian.

Realizimi i qëllimeve të këtij plani do të shkojë paralelisht edhe me Procesin e Berlinit dhe zbatimin e marrëveshjes për tregun e përbashkët rajonal.

Komisioni Evropian beson se konvergjenca ekonomike është element thelbësor për t'i sjellë

vendet e Ballkanit Perëndimor më afër Bashkimit Evropian.

Plan i ri për rritje në Ballkanin Perëndimor është i bazuar në katër shtylla.

Shtylla e parë është "forcimi i integritimit ekonomik në tregun unik të BE-së". Kjo do të varet nga përshtatja e vendeve të rajonit me rregullat e tregut unik dhe paralelisht hapja e tregut të tyre në sektorët përkatës për vendet fqinje.

Shtylla e dytë e këtij plani është "forcimi i integritimit ekonomik brenda Ballkanit Perëndimor përmes tregut të përbashkët rajonal". Kjo, sipas përvojës së BE-

së, do të ndikojë në një rritje potenciale ekonomike prej 10-përqindësh.

Shtylla e tretë e këtij plani është "përsheptimi i reformave fundamentale". Kjo nënkupton sundimin e ligjit që ndihmon edhe në tërheqjen e investimeve direkte të huaja dhe forcon stabilitetin rajonal.

Shtylla e katërt e planit të ri të Komisionit Evropian për rritje ekonomike në Ballkanin Perëndimor është "rritja e asistencës financiare për t'i ndihmuar reformat". Këtu përfshihet edhe propozimi për 6 miliardë euro ndihmë.

## Nënshkruhet marrëveshja për mbështetje për marrjen e vlerësimit kreditor të Kosovës

Prishtinë, 9 nëntor - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), Hekuran Murati, drejtoresha në detyrë e Misionit të USAID-it në Kosovë, Kerry Monaghan Hogler dhe zëvendës-drejtori i Projektit "Promovim të investimeve dhe qasje në financa", Artan Loxha, nënshkruan marrëveshje për mbështetje në marrjen e vlerësimit kreditor për Kosovën. Sipas njoftimit për medie, thuhet se në kuadër të marrëveshjes së mirëkuptimit parashihen aktivitetet e përbashkëta si edhe mbështetja që USAID-i do të ofrojë për Republikën e Kosovës në marrjen e vlerësimit kreditor. "Marrja e vlerësimit kreditor ka një rëndësi të veçantë sepse mundëson që investitorët e huaj të kenë një pasqyrë të qartë të mundësive dhe përfitimeve nga investimet që ata bëjnë në Kosovë si dhe rritë besueshmërinë mbi stabilitetin



financiar të vendit", thuhet në njoftim.

Në veçanti Murati theksoi se: "Si Ministri përgjegjës për

Financa është shumë me rëndësi që të sigurojmë qasje sa më të lehtë në financa për të gjitha institucionet financiare,

andaj marrja e vlerësimit kreditor për vendin është një hap tjetër i rëndësishëm në këtë drejtim".

Në anën e saj, Monaghan Hogler shprehu se vlerësimi kreditor do t'i ofrojë Kosovës qasje më të madhe në tregjet kapitale ndërkombëtare si dhe do t'i zvogëlojë kostot e huamarrjes.

Drejtoresha në detyrë, Monaghan Hogler, gjithashtu theksoi rëndësinë e vlerësimit kreditor për ta rritur besimin e investitorëve dhe për ta bërë Kosovën më tërheqëse për investimet e huaja. "Gjithashtu, përgjatë këtij takimi u diskutua edhe për projektet aktuale në mes të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Misionit të USAID-it në Kosovë. Me këtë rast, ministri Murati njoftoi Monaghan Hogler lidhur me mbarëvajtjen e Projektit për Qeverisje Ekonomike, Projektit për Integritet Komunal si dhe Projektit për Promovim të Investimeve dhe Qasje në Financa dhe e falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme të USAID-it", thuhet në njoftim.





## Inzaghi: Asllani po më bind pas çdo ndeshje, po rritet shumë

MILANO, 9 NËNTOR - Ky është sezoni më i mirë i Interit në drejtimin e Simone Inzaghit, të paktën deri më tani, por llogaritë bëhen në fund, për këtë arsye Inzaghi nuk dëshiron të nxitohet për të dalë në një përfundim, thjesht

shijon kualifikimin për më tej në Ligën e Kampionëve. "Nëse ky është sezoni im më i mirë në tre vitet e fundit, këtë do ta tregojë koha. Ne dimë që sa vjen e do të bëhet më e vështirë. Duhet të vuajmë të gjithë së bashku. Nuk ka

ndeshje të lehta në Ligën e Kampionëve, mbase i lejuam diçka më shumë", u shpreh Inzaghi i cili nuk ngurroi t'i bëjë edhe një herë komplimente Kristjan Asllanit për paraqitjen e bërë. "U fut mirë në lojë, po e bën gjithnjë këtë në mënyrë

konstante. Doja që ai të luante pasi po rritet ndeshje pas ndeshje. Më vjen në mendje sfida në Bergamo, apo një tjetër ndeshje më herët. Nuk është e lehtë të futesh në këtë mënyrë në ndeshje të tilla. Asllani po më bind gjithnjë e më shumë,



ndeshje pas ndeshje", u shpreh Inzaghi.

## Bushi: E kemi kontaktuar Ibrahimoviçin, por ai ndoshta e pret Gjermaninë

TI RANË, 9 NËNTOR - Shqipëria U-21 luan përballë Rumanisë dhe Malit të Zi në sfidat e vlefshme për kualifikueset e Evropianit 2025. Trajneri i Shpresave, Alban Bushi, foli se çfarë pret nga këto dy takime dhe, gjithashtu, u ndal tek Arijon Ibrahimoviçi, që po bën mjaft mirë me Frosinonen në Serinë A.

*A është skuadra gati? Mund të përsëriten sukseset që kemi pasur në Elbasan dhe Rrogozhinë?*

Gjëja më e mirë është që në 5 muajt e fundit kemi bërë ndeshje. Kjo është diçka shumë e mirë për ekipin, pasi lojtarët janë konsoliduar dhe janë njohur shumë mirë me njëri-tjetrin dhe pak a shumë atë stil loje që ne kemi menduar të luajmë, ata e dinë shumë mirë se çfarë duhet të bëjnë. Kjo është gjëja më e rëndësishme dhe për këtë ndihem mirë. Ndihej mirë dhe që jemi në vendin e parë. Edhe pse kundërshtarët kryesorë kanë një ndeshje më pak, kjo nuk do të thotë asgjë, sepse të jesh në vend të parë në këtë grup është diçka e mirë. Mendoj se Rumania, ashtu dhe Mali i Zi, janë kundërshtarë shumë të fortë. I njohim shumë mirë, siç na njohin ata ne. Do të bëjmë diçka ndryshe. Nga



ndeshja e parë me Rumaninë duhet të jemi më pak të ekuilibruar, sepse ndeshjen që kemi bërë këtu na kanë kapur shumë herë në kundërsulme. Do të mundohemi të jemi më mirë në ndeshjen atje. Dhe me Malin e Zi, sepse është një ekip në nivel pothuajse me ne.

*Dyrisi nga kampionati shqiptar. A është për t'i motivuar të tjerët për të ardhmen?*

Mendoj se janë dy lojtarë me perspektivë. Rashica është datëlindja 2004, gjithashtu edhe Beqaj. Mendoj se janë lojtarë

shumë të mirë. Rashica është hera e parë që vjen me ne, ka qenë lojtar i të rinjve të Kosovës. Unë e falënderoj që ka zgjedhur Shqipërinë. Mendoj se shpejt do t'i dalë pasaporta dhe ta kemi gati për ndeshjen e radhës. Shqipëria nuk është se ka shumë lojtarë të rinj në kampionatin vendas. Nuk u jep shumë dorë të rinjve. Ky është një problem i madh për ekipin Kombëtar U-21, se nuk ka ku kërkon lojtarë dhe jemi munduar të kërkojmë gjithmonë jashtë. Edhe pak lojtarë që dalin në kampionatin shqiptar, nuk punohet shumë me ta nga ana individuale për t'i rritur si fizikisht e taktikisht.

*Ibrahimoviçi po bën mirë në Serinë A. Ka pasur interes nga FSHF-ja për ta afruar?*

Çdo lojtar shqiptar, kudo që është, në çdo kampionat të Evropës, ne e kontaktojmë. Nuk diskutohet fare që ka pasur kontakt nga Shqipëria, por për arsye të njëanshme të lojtarit, mund të presë Gjermaninë ose diçka tjetër, për këtë arsye nuk është thirrur. Por çdo lojtar shqiptar, që është në kampionatet e Evropës, sidomos që ka nivel për ekipin kombëtar, është kontaktuar 100% nga ne.

## Denveri thyen rivalët e Golden States, Philadelphia merr kreun në Lindje

DENVER, 9 NËNTOR - Denveri mbetet skuadra më e mirë në NBA, duke mundur me rezultat 108-105 Golden States, në një sfidë të ekuilibruar dhe me rivalitet deri në fund. Të gjithë titullarët e Denverit realizuan mbi 10 pikë. Dallimin e bëri Nikola Jokiqi, autor i 35 pikëve e 13 reboundeve. Curry realizoi 2 pikë për Warriorsin, por që mbetën për statistikë. Philadelphia merr kreun e renditjes në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 106-103 ndaj Bostonit, dy ekipe që synojnë titullin. Porzingis realizoi 29 pikë për Celticsin, por që s'mjaftuan për ta shmangur humbjen. Për Philadelphiaian



shkëlqyen Embiid me 27 pikë e 10 rebounde si dhe Maxey me 25 pikë. Fitore e vështirë edhe për Milwaukeeen, që mundi me rezultat 120-118 Detroitin, sfidë ku u dallua Lillard me 34 pikë. Houstoni u jep leksion lakersave, duke fituar thellë me shifrat 128-94. Green me 28 pikë ishte më i miri për teksanët. Pas kohës shtesë fitoi Phoenixi, që mundi

### REZULTATET

Charlotte - Washington	116-132
Indiana - Utah Jazz	134-118
Philadelphia - Boston	106-103
Brooklyn - Clippers	100-93
New York - San Antonio	126-105
Chicago - Phoenix	115-116
Houston - Lakers	128-94
Memphis - Miami	102-108
Milwaukee - Detroit	120-118
Minnesota - New Orleans	122-101
Oklahoma - Cleveland	128-120
Dallas - Toronto	116-127
Denver - Golden State	108-105
Sacramento - Portland	121-118

Chicagon (116-115) me dyshen Alle Durant që realizuan 51 pikë.

### SHKURT

#### Tuchel: Jam krenar me paraqitjen e ekipit

Bayern Muncheni e mposhti Galatasarayn (2-1) dhe arriti kualifikimin në Ligën e Kampionëve. Trajneri Thomas Tuchel ka thënë se kjo nuk ishte ndeshja më e mirë nga skuadra që ai e drejton, por në përgjithësi është krenar me paraqitjen e ekipit. "Nuk ishim shumë agresivë në zonën e kundërshtarit, por kjo vjen edhe nga lodhja e madhe, por në përgjithësi jam krenar për paraqitjen e ekipit", ka deklaruar Tuchel.

#### Pique: Girona sikurse Leicesteri

Skuadra e Gironas deri tash është befasia më e madhe në La Liga pasi kryeson kampionatin me dy pikë më shumë se Real Madridi dhe katër më shumë se Barcelona. Ish-anëtari i Barcelonës, Gerard Pique, e ka krasuar Gironën me skuadrën e Leicester Cityt kur e fitoi Premierë Ligën. "Girona po ngjan gjithnjë e më shumë me Leicesterin. Nuk do të jetë e lehtë për të, por e njëjta gjë u tha për Leicesterin kur fitoi Premierë Ligën. Është një projekt që duhet admiruar", ka deklaruar Pique.

#### Silva: Fundi i karrierës sime po vjen

Thiago Silva është një nga futbollistët më të rëndësishme të Chelseas së Mauricio Pochettino. Megjithatë, veterani brazilian e di që karriera e tij po shkon drejt fundit. "Fund i karrierës sime po vjen dhe nuk është një gjë e thjeshtë", ka thënë Silva. "Duhet të vendos nëse do të ndalem apo do të vazhdoj të luaj. Nëse do të vazhdoja, ku do të shkoja të luaja. Kam familje, kam dy djem që luajnë për Chelsean. Për momentin jam duke menduar vetëm për të luajtur dhe për ta shfrytëzuar maksimalisht këtë vit të fundit të kontratës sime me Chelsean, atëherë do të shohim", ka theksuar ish-futbollisti i Milanit dhe PSG-së.

#### Wilderi braktis ringun për kafazin: Dua ta mbyll karrierën në MMA

Boksieri amerikan Deontay Wilder po planifikon të lërë ringun dhe të nisë një karrierë në MMA, disiplinë ku synon të luftojë përpara se të tërhiqet nga sporti. Wilderit i lindi kjo dëshirë pas duellit në mes të Francis Ngannout dhe Tyson Furyt. Tifozët shpresojnë ta shohin Wilderin dhe Ngannout të nënshkruajnë një marrëveshje me dy ndeshje, e cila do t'i shihte ata në kafaz dhe në ring. Gjithsesi, Wilderi ka konfirmuar interesimin e tij për MMA. Duke folur për "Blue Blood Sports TV", Wilderi ka deklaruar: "Po mendoj t'i bëj të dyja, UFC dhe boks. Do të jem një njeri i rrezikshëm në UFC me doreza më të vogla. Më vjen të marr një trup të madh dhe ta përplas, pastaj t'i hipi sipër dhe ta rrah keq". Wilderi nuk e ka përmendur Ngannout si kundërshtar, por boksieri amerikan, ish-kampion bote në peshën e rëndë, ka marrë pjesë në seancat MMA derisa fliste me gazetarin e njohur Ariel Helwani në fillim të kësaj jave. Ai që e konfirmoi këtë gjë është vetë Ngannou. "Deontay Wilder për disa muaj është trajnuar me MMA. Asgjë nuk është vendosur, por disa gjëra më kanë tërhequr vëmendjen, kështu që kjo është diçka që ka kuptim. Ai është vërtet serioz për t'u ndeshur në MMA. Është shumë i interesuar për MMA, por do të jetë një sfidë ndryshe për të", ka deklaruar Ngannou.

## Ten Hag: Dominuam edhe me dhjetë futbollistë

Manchester Unitedi pësoi humbje nga Copenhageni (4-3) në kuadër të grupeve në Ligën e Kampionëve. Pas kësaj humbje, Trajneri Erik Ten Hag u ankua për kartonin e kuq të dhënë ndaj


Rashfordit në fund të pjesës së parë. Ai ka thënë se skuadra e tij ka dominuar edhe me dhjetë futbollistë. "Ai karton i kuq dhe mënyra se si u gjykua kjo ndeshje, nuk ka të bëjë fare me

futbollin. Në golin e parë të Copenhagenit një lojtar i tyre qëndronte para Onanas dhe ai gol duhej anuluar për pozicion jashtë lojës. Kjo ndeshje nuk duhej të shkonte në këtë mënyrë,

se nuk ka lidhje me futbollin. Jam dakord që gjyqtarët duhet të marrin vendime të vështira në fushë dhe mund të gabojnë, por jo në këtë mënyrë. Më mbetet vetëm të marr më të mirat e

ndeshjes. Më pëlqeu fakti që edhe me 10 lojtarë sërish kishim kontroll në lojë. Sjellja e skuadrës në fushë ishte e shkëlqyer. Nuk mund t'i bëj asnjë kritikë ekipit", ka thënë Ten Hag.

**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Envert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



# Ballkani merr një pikë në Kazakistan

Ndryshe nga ndeshja e zhvilluar në “Fadil Vokrri” ku Ballkani humbi 1-2 ndaj Astanas, kampionët e Kosovës të enjten në Kazakistan arritën të marrin një pikë dhe të ruajnë shpresat për kualifikim në fazën tjetër të Ligës së Konferencës



**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 9 NËNTOR** - Skuadra kampione e Kosovës, Ballkani ka bërë një paraqitje të mirë në Kazakistan ku edhe arriti të marrë rezultat pozitiv ndaj Astanas (0-0). Ndeshja u zhvillua të enjten në “Astana Arena” dhe i ka takuar xhiros së katërt në grupet e Ligës së Konferencës. Djelmohat e drejtuar nga Ilir Daja ishin dominues, por fati nuk ishte në anën e tyre dhe nuk arritën të shënojnë golin e fitore, prandaj është dashur të kënaqen me një pikë nga kjo ndeshje. Rastet më të mirë në pjesën e parë për skuadrën kosovare i kishin Nazmi Gripshi dhe Almir Kryeziu, kurse Gripshi pati

edhe një rast në pjesën e dytë. Trajneri Ilir Daja pas ndeshjes është shprehur se skuadra e Ballkanit ka merituar më shumë se një pikë nga kjo përballje. Trajneri shqiptar më pas e ka pranuar se janë shtuar apetitet e klubit për të synuar kalimin e grupit. “Besoj se meritoni më shumë sepse kemi kontrolluar më shumë topin, në përqindjen më të madhe e kemi diktuar lojën. Kemi pasur shanset tona që po të kishim shënuar do ta kishim fituar lojën. Kemi bërë një lojë shumë të mirë, sepse ndryshimi i orarit gati 5 orë me Kosovën është e ndjeshme por nuk e hetuam këtë. Bëmë një lojë akoma më të mirë se në Prishtinë edhe pse kishim përball një ekip të fortë fizikisht

dhe taktikisht. Jam i kënaqur edhe me barazimin edhe pse fitorja do të ishte edhe rezultat më i mirë. Ne nuk kemi pasur objektiv kalimin e grupit, por kjo pritshmëri është rritur pas fitores me Dinamon. Ne do të vazhdojmë të japim kontributin për ta prezantuar më së miri futbollin e kampionatit të Kosovës dhe pastaj do t'i numërojmë pikët në fund të fazës së grupit”, ka thënë Daja. Pas këtij barazimi, Ballkani tani ka katër pikë, kurse ndeshjen e radhës e luan më 30 nëntor kundër Viktoria Plzenit në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. Katër pikë ka edhe Astana, derisa Dinamo Zagreb ka tri pikë, përderisa në vendin e parë është Viktoria Plzen me 12 pikë.

## SHKURT

### Rrahmani: Ende nuk e di a do të luaj ndaj Izraelit

Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, ende nuk e di nëse do t'u bashkohet “dardanëve” për ndeshjen e së dielës kundër Izraelit. UEFA ka vendosur që ndeshja e shtyrë e muajit të kaluar, Kosovë - Izrael, e vlefshme për kualifikimet e “Euro 2024”, të luhet këtë të diel, në një fundjavë kur ligat vazhdojnë të luajnë. Pikërisht në fundjavë, Napoli do të luajë me Empolin në Serinë A, por përfaqësuesi i Kosovës nuk e di nëse do të jetë i pranishëm në këtë lojë apo do t'i bashkohet Kosovës. “A do ta humbi ndeshjen Napoli - Empoli për shkak të Kombëtares? Nuk e di ende, jemi duke e vlerësuar”, ka deklaruar Rrahmani për “TuttoNapoli”.

### Sot derbi Prishtina - Peja 03

Xhiroja e gjashtë do të fillojë të premten me dy ndeshje mjaft interesante. Ndeshja kryesore do të zhvillohet në Prishtinë. Vashat nga kryeqyteti janë nikoqire te Peja 03. Ballafaqimi i dy skuadrave fillon nga ora 17:00. Trepça - Bashkimi është ndeshja hapëse e kësaj xhiroje e cila zhvillohet të premten me fillim nga ora 13:30. Të shtunën zhvillohet ndeshja e fundit e xhiros së gjashtë në mes të Penzës dhe United Basketballit me fillim nga ora 16:00. Në ciklin e parë garues fituesit e ndeshjeve ishin Prishtina, Bashkimi dhe Penza.

### Real ‘blindon’ edhe Valverden

Real Madridi ka konfirmuar zyrtarisht rinovimin e kontratës me mesfushorin uruguaian Federico Valverde. Pas Vinicius Junior, Rodrygo Goes dhe Edouardo Camavinga, tani radha ishte për Valverden, i cili edhe për gjashtë vjet do të jetë pjesë e Realit. “Real Madrid CF dhe Fede Valverde kanë rënë dakord për ta vazhduar kontratën e lojtarit, i cili mbetet i lidhur me klubin deri më 30 qershor 2029”, thuhet në njoftim. Valverde ka luajtur 220 ndeshje me Realin, në të cilat ka shënuar 19 gola dhe ka fituar 9 tituj.

### Al-Hilali pezullon kontratën e Neymarit

Lajme aspak të mira për Neymarin. Pas dëmtimit të rëndë me fanellën e Brazilit dhe tentativës për rrëmbim të partneres dhe vajzës së tij, lojtari i Cariocas duhet të përballet me pezullimin e kontratës nga Al-Hilal. Klubi saudit ka vendosur ta pezullojë përkohësisht kontratën e ish-lojtarit të Barcelonës për shkak të dëmtimit të rëndë që pësoi, për të liru vend për një tjetër të huaj në janar. Masa hyn në fuqi duke filluar nga ky dimër, ndërkohë Neymar do të lihet jashtë skuadrës nga Jorge Jesus, i cili mori vendimin në marrëveshje me klubin siç komunikohet nga media saudite Arriyadiyah. Pas dëmtimit të rëndë në gju, sulmuesi pritet të mungojë në të gjithë sezonin. Ai pritet të rikthehet në fushë vetëm në vitin 2024, duke bërë që Al-Hilali të vendosë që të ndërhyjë në merkato.

## Spektakël sportiv në Malishevë, Rudaj mbron titullin në ‘Muay Thai’

**MALISHEVË, 9 NËNTOR** - Më 11 nëntor kampioni nga Malisheva, Luan Rudaj, do ta mbrojë titullin në sportin “Muay Thai” kundër iraniantit Masoud Raeisi. Lajmin e ka konfirmuar kryetari i Malishevës, Ekrem

Kastrati, i cili ka paralajmëruar se kjo do të jetë ngjarja më e madhe sportive e organizuar ndonjëherë në këtë komunë. “Ngjarja më e madhe sportive e organizuar ndonjëherë nga komuna e

Malishevës po afrohet. Kampioni ynë, bashkëvendësi Luan Rudaj, do ta mbrojë titullin e botës në sportin ‘Muay Thai’ kundër iraniantit Masoud Raeisi. Kjo ngjarje e madhe, që do të shoqërohet edhe me

disa ndeshje të tjera dhe me një program të pasur artistik, siç edhe jeni të informuar, do të zhvillohet këtë të shtunë, më 11 nëntor 2023, me fillim nga ora 16:00. Ju mirëpresim!”, ka shkruar Kastrati në “Facebook”.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR

AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1231/1

Dt: 09.11.2023

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj dhe Qendrën e Kompetencës "Shtefen Gjeçovi", në Prishtinë

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
QeK	Qendra e Kompetencës	Skenderaj	Një (1) Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e	Vendi lirë
QeK	Qendra e Kompetencës "Shtefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtinë	Dy (2) Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/c	Vendi lirë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për pozitën: Punëtor teknik

- Ndihmon stafin për rregullimin e orendive të shkollës;
- Ndihmon menaxhmentin/personelin mësimdhënës të shkollës për realizimin e punëve teknike;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore.
- Bën mirëmbajtjen e pastërtisë së gjithë objektit;
- Merr pjesë në rregullimin e hapësirave të jashtme shkollore, si dhe detyra shtesë të cilat i ndan drejtori i shkollës.

### Kualifikimi dhe shkathësitë e kërkuara:

- Kandidati duhet të ketë Shkollën e mesme,
- Kandidati
- Li ose ajo duhet të jenë gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti

### Aftësitë shtesë

- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm për institucionin,
- Plotësisht i besueshëm ndaj institucionit, objektivave dhe synimeve të stafit drejtues, si dhe personelit të shkollës.


Paga bazë: 394.80 euro

Kontrata: Kohëzgjatja e periudhës provuese është gjashtë (6) muaj

Orari: 40 orë pune në javë

### Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilin është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj dhe Qendrën e Kompetencës "Shtefen Gjeçovi", në Prishtinë.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk jeni nën hetim dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Biznesi "HAVOLLI DEKOR" SH.P.K. ne numër unik: 811548611, njofton opinionin për uljen e vlerës së kapitalit të biznesit nga 10,000 euro ne vlerën 1,000 euro.

### >> SHPLLJE TË VOGLA <<

- Semira Rami shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

Alorent Magi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme të Gjimnazit "Hajdar Dushi".

Nue Karica shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Zef Lush Marku " Velezhe.

Tomë Marku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Dëshmorët Lleshi".

Pali Morina shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu " Luigj Gurakuqi " Nashec .

Halil Rugova nga Istogi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike " Nexhmedin Nixha".

Habib Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

Donart Ibrahim shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

Greta Hadri shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Mati Logoreci " Prizren .

Lulzim Musa shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

Elmir Ponik shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Mic Sokoli " Lubeqev.

"Idea A" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811447996.

Arlind Cikaj shpall te pavlefshme dëftesat e kp I - VIII shfmu " Luigj Gurakuqi " Nashec.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

Gjelal Ukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dëshmorët e Korishit " Korishe.

